



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 19.01.2018, Nr. 09-111-4209



Në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, të nenit 5 pika c të ligjit mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 79 pika (e) e Statutit të Komunës së Drenasit, Drejtori për Arsim, shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës në institucionet arsimore:

1. Një punëtor, Tekniko – Shërbyes (Pastrues) në SHFMU “ 24 Korriku “ – Fushticë e Poshtme.

KRITERET E PUNËSIMIT PËR PUNËTOR TEKNIKO – SHËRBYES:

- Shkolla e mesme

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Diploma origjinale, ose e vërtetuar në Komunë apo të Noteri publik.
3. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetim, jo më e vjetër se gjashtë muaj.
4. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim ose patentë shoferi)

REKRUTIMI:

Intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidateve do ta bëjë komisioni i DKA-së. Në intervistë do të ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e këtij konkursi. Kandidati i cili përzgjidhet nga komisioni intervistues obligohet që brenda afatit të ankesave ta sjellë në DKA çertifikatën mjekësore për gjendjen shëndetsore lidhur me çështjen e punësimit, në të kundërtën do të nënshkruhet kontrata e punës me kandidatin e dytë më radhë për të cilin vlen e njëjta rregullë.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së, G-11, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.



Drejtori për Arsim

Tafil Halilaj